Kuvendi komunal formon Këshillin shfrytëzues të shërbimeve publike si trup të përhershëm punues të përbërë nga 7 anëtarë.

Ky Këshill i shqyrton planet, programet dhe raportet e shërbimeve publike dhe për qëndrimin e tij e njofton Kuvendin e komunës dhe opinionin publik.

Këshilli shfrytëzues i shërbimeve publike veçmas merret me shqyrtimin e nivelit të kualitetit dhe vëllimin e shërbimeve të realizuara nga shërbimet publike, si dhe çmimin e produkteve dhe shërbimeve

komunale, përkatësisht lartësinë e kompensimit të shërbimeve publike, nga ndërmarrjet përkatëse.

240

Anëtarët e Këshillit shfrytëzues të shërbimeve publike i zgjedhë Kuvendi komunal me propozim të trupave punues të Kuvendit të komunës, grupeve të këshilltarëve dhe shoqatave të qytetarëve.

Kryetari dhe së paku gjysma e anëtarëve të Këshillit shfrytëzues nuk mund të jenë nga përbërja e këshilltarëve, funksionarëve dhe të punësuarëve në Administratën komunale, përkatësisht në shërbimet publike themelues i të cilave është Komuna.

Me ndërprerjen e mandatit të Kuvendit komunal, i ndërpritet mandati edhe anëtarëve të Këshillit shfrytëzues.

– Komisioni zgjedhor

- Neni 52.

4.

Komisionin zgjedhor e përbëjnë kryetari dhe 4 anëtarë të cilët i emëron Kuvendi i komunës.

Komisioni zgjedhor e ka sekretarin të cilin e emëron Kuvendi komunal dhe i cili merrë pjesë në punën e Komisionit zgjedhor pa të drejtën e vendosjes.

Kryetari, anëtarë e Komisionit zgjedhor dhe sekretari emërohen në katër vjet, ndërkaq pas skadimit të mandatit mund që sërish të riemërohen.

Kryetari, anëtarët e komisionit zgjedhor dhe sekretari i kanë zëvendësit e tyre.

Për kryetar, zëvendës kryetar, sekretar dhe zëvendës sekretar të Komisionit zgjedhor emërohen personat që kanë arsimin superior nga sfera shkencore e shkencave juridike në studimet themelore akademike në vëllim prej së paku 240 ECTS pikë, në studimet akademike master, në studimet profesionale master, në studimet specialistike akademike, në studimet profesionale specialistike, përkatësisht në studimet themelore në kohëzgjatje prej së paku katër vjetë ose në studimet specialistike në fakultet, me së paku tre vjet pune në profesion.

Komisioni zgjedhor i zbaton zgjedhjet për anëtarë të Këshillit të bashkësive lokaleve ekskluzivisht në përbërje të plotë.

Anëtarët e Komisionit zgjedhor dhe zëvendësit e tyre mund të jenë vetëm qytetarët që kanë të drejtë zgjedhore, si dhe vendbanim në Komunën e Bujanocit.

Detyrat dhe autorizimet e Komisionit zgjedhor

- Neni 53.

Komisioni zgjedhor me rastin e zbatimit të zgjedhjeve për Këshillin e bashkësisë lokale:

1)

kujdeset për ligjshmërinë e zbatimit të zgjedhjeve për anëtarë të Këshillit të bashkësisë lokale;

2)

i cakton njësitë zgjedhore;

3)

- 4) i cakton këshillat zgjedhor dhe i emëron anëtarët e tyre;
- Detyrat dhe autorizimet e Komisionit zgjedhor, si dhe mënyra e punës dhe e vendimarrjes, më për së afërmi rregullohen me vendimin e Kuvendit komunal me të cilën rregullohen bashkësitë lokale.
- Komisioni
zgjedhor i shkallës së dytë
- Neni 54.
- 5) jep udhëzime këshillit zgjedhor sa i përket zbatimit të procedurës zgjedhore për anëtar të këshillit të bashkësisë lokale;
- 6) i përpilon ekstraktet dhe organizon përgatitjet teknike për zbatimin e zgjedhjeve;
- Komisioni zgjedhor i shkallës së dytë është organ për zbatimin e zgjedhjeve i cili vendosë në shkallë të dytë mbi kundërshtimet ndaj vendimeve të Komisionit zgjedhor.
- 7) përcakton nëse listat zgjedhore janë përpiluar dhe paraqitur në pajtim me Udhëzimin për zbatimin e zgjedhjeve për anëtar të bashkësisë lokale;
- Komisioni zgjedhor i shkallës së dytë përbëhet prej kryetarit dhe dy anëtarëve.
- 8) e shpallë listën e kandidatëve;
- 9) përcakton formën dhe dukjen e fletës së votimit, numrin e tyre për vendvotime dhe me proesverbal ia dorëzon këshillave zgjedhore;
- Komisioni zgjedhor i shkallës së dytë e ka sekretarin të cilin e emëron Kuvendi komunal dhe i cili merrë pjesë në punën e Komisionit zgjedhor pa të drejtën e deklarimit/votës.
- 10) vendosë mbi kundërshtimet të ushtruar në procedurën e zgjedhjes për anëtar të Këshillit të bashkësisë lokale;
- Komisioni zgjedhor i shkallës së dytë vendosë me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.
- 11) i çertifikon dhe i publikon rezultatet e zgjedhjeve për anëtarë të bashkësisë lokale;
- Kryetari, së paku një anëtar dhe sekretari Komisionit zgjedhor të shkallës së dytë duhet të kenë arsimin superior nga sfera shkencore e shkencave juridike në studimet themelore akademike në vëllim prej së paku 240 ECTS pikë, në studimet akademike master, në studimet specialistike akademike, në studimet profesionale specialistike, përkatësisht në studimet themelore në kohëzgjatje prej së paku katër

vjetë ose në studimet specialiste në fakultet, me së paku pesë vjet pune në profesion.

të fshehtë, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës.

Kryetari, anëtarët e Komisionit zgjedhor të shkallës së dytë dhe sekretari emërohen në katër vjet, ndërkaq pas skadimit të mandatit mund që sërish të riemërohen.

Këshilltari mund të marrë pjesë më propozimin e vetëm një kandidati.

Detyrat dhe autorizimet e Komisionit zgjedhor të shkallës së dytë, si dhe mënyra e punës dhe e vendimarrjes, më për së afërmi rregullohen me vendimin e Kuvendit të komunës me të cilin rregullohen bashkësitë lokale.

Nëse janë propozuar më shumë kandidatë, ndërkaq asnjëri prej kandidatëve nuk e merrë shumicën e nevojshme të votave, procedura e kandidimit dhe e zgjedhjes përsëritet.

Shkarkimi i kryetarit të Kuvendit

- Neni 57.

- Kryetari i Kuvendit

- Neni 55.

Kuvendi komunal ka kryetarin e Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit mund të shkarkohet para skadimit të mandatit:

- 1) me kërkesë personale,
- 2) Me propozimin e së paku një të tretës së këshilltarëve.

Kryetari i Kuvendit e organizon punën e Kuvendit komunal, konvokon dhe i kryeson seancat e Kuvendit, realizon bashkëpunimin me kryetarin e Komunës dhe me Këshillin komunal, kujdeset për jetësimin e transparencës në punë, nënshkruan aktet që sjell Kuvendi i Komunës, dhe kryen edhe punë të tjera të parapara me ligj dhe me këtë Statut.

Propozimi paraqitet në formë të shkruar dhe patjetër duhet të jetë i arsyetuar.

Shkarkimi bëhet në mënyrën dhe procedurën e njëjtë sikur edhe me rastin e zgjedhjes së tij.

- Zëvendës

kryetari i Kuvendit

- Neni 58.

Kryetari i Kuvendit të komunal mund të jetë në punë të përhershme në Komunë.

- Neni 56.

Kryetari i Kuvendit e ka zëvendësin i cili e zëvendëson në rast të mungesës së tij dhe kur ai është i penguar ta ushtroj detyrën e tij.

Kryetari i Kuvendit zgjedhet nga radhët e këshilltarëve, me propozim të së paku një të tretës së këshilltarëve, në kohëzgjatje prej 4 vjetësh, me votim

Zëvendës kryetari i Kuvendit zgjedhet dhe shkarkohet në të njëjtën mënyrë sikur edhe kryetari i Kuvendit.

Nëse zëvendësit të kryetarit të Kuvendit i pushojnë të drejtat nga mardhënia e punës për shkak të zgjedhjes së tij në këtë funksion, zëvendësi i kryetarit të Kuvendit mund të jetë në mardhënie të rregullt pune.

– Sekretari i Kuvendit

- Neni 59.

Kuvendi komunal ka sekretarin i cili kujdeset për kryerjen e punëve profesionale në lidhje me konvokimin dhe mbajtjen e seancave të Kuvendit dhe të trupave të tija punuese dhe udhëheq me punët administrative lidhur me punën e tyre.

Sekretari i Kuvendit caktohet në mandatin 4 vjeçar me propozim të kryetarit të Kuvendit dhe mund caktohet përsëri.

240

Për sekretar të Kuvendit mund të caktohet personi që e ka arsimin superior nga sfera shkencore e shkencave juridike në studimet themelore akademike në vëllim prej së paku 240 ECTS pikë, në studimet akademike master, në studimet specialistike akademike, në studimet profesionale specialistike, përkatësisht në studimet themelore në kohëzgjatje prej së paku katër vjetë ose në studimet specialistike në fakultet, ta ketë të dhënë provimin profesional për punë në organet e administratës dhe me përvojë pune prej së paku tri vjet.

Kuvendi komunal mundet që me propozim të arsyetuar të Kryetarit të Kuvendit, ta shkarkoj sekretarin para skadimit të mandatit.

Sekretari i Kuvendit e ka zëvendësin i cili e zëvendëson në rast të mungesës së tij.

Zëvendës sekretari i Kuvendit të komunës caktohet dhe shkarkohet në të njëjtën mënyrë dhe nën kushte të njëjta si edhe sekretari.

Sekretari i Kuvendit është përgjegjës për dërgimin me kohë të të dhënave dhe shkresave dhe dokumenteve kur këtë e kërkon organi kompetent i Republikës i cili bënë mbikqyrjen ndaj punës dhe të akteve të Kuvendit të Komunës.

– Rregullorja e Kuvendit

- Neni 60.

Mënyra e përgatitjes, udhëheqjes dhe e punës së seancës së Kuvendit të komunës dhe të trupave të saja punuese dhe të çështjeve të tjera lidhur me punë Kuvendit, rregullohet me rregulloren e Kuvendit.

Rregullorja miratohet nga Kuvendi me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve.

Për zbatimin e Rregullores kujdeset dhe është përgjegjës kryetari i Kuvendit.

2. – Organet ekzekutive të Komunës

– Organet ekzekutive

- Neni 61.

:

Organet ekzekutive të Komunës janë kryetari i Komunës dhe Këshilli komunal:

) **- Kryetari i Komunës**

Zgjedhja e kryetarit dhe zëvendësit të kryetarit të Komunës

- Neni 62.

Kryetarin e Komunës e zgjedh Kuvendi i komunës, nga radhët e këshilltarëve, në mandate prej 4 vjetësh, me votim të fsheht, me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve të Kuvendit.

Kryetari i Komunës e ka zëvendësin e tij i cili e zëvendëson në rast të mungesës së tij apo në rastet kur është i penguar të kryej detyrën e tij.

Kryetari i Kuvendit të komunës e propozon kandidatin për kryetar të Komunës.

Kandidati për kryetar të Komunës e propozon kandidatin për zëvendës kryetar të Komunës, nga radhët e këshilltarëve, të cilin e zgjedhë Kuvendi komunal në të njëjtën mënyrë si kryetarin e Komunës.

- Mospërputhja e funksioneve

- Neni 63.

Kryetarit të Komunës dhe zëvendës kryetarit të Komunës me zgjedhjen e tyre në këto funksione iu ndërpritet mandati i këshilltarit në Kuvendin komunal.

Kryetari i Komunës dhe zëvendës kryetari i Komunës janë në mardhënje të përhershme të punës në Komunë.

- Kompetenca

- Neni 64.

:

Kryetari i komunës:

- 1) ;
e prezenton dhe e përfaqëson Komunën,
- 2) ;
propozon mënyrën e zgjidhjes së çështjeve për të cilat vendosë Kuvendi komunal;
- 3) ;
është urdhërdhënës i ekzekutimit të buxhetit;
- 4) ;
themelon shërbimin komunal për inspektimin e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore dhe shërbimin për auditim të brendshëm të Komunës;
- 5) ;
themelon fondin buxhetor dhe e përcakton programin e shfrytëzimit të mjeteve të fondit buxhetor, në pajtim me ligjin;
- 6) ;
jep pëlqimin ndaj akteve të përgjithshme me të cilat rregullohet numri dhe struktura e të punësuarëve dhe i personave të tjerë që angazhohen më jetësimin të programit të shfrytëzuesit të buxhetit të Komunës ose të një pjese të tij;
- 7) ;
e orienton dhe e harmonizon punën e Administratës komunale;
- 8) ;
e prezenton Këshillin komunal, i konvokon dhe i udhëheq seancat e tij;
- 9) ;
nxjerr aktet individuale për të cilat është i autorizuar me ligj, me këtë statut ose me vendim të Kuvendit komunal;

- 10) ;
nxjerrë aktvendim mbi dhënien me qira të tokës ndërtimore në pronësi publike të Komunës në pajtim me ligjin, me rregullat e tjera dhe me programin e shfrytëzimit të tokës ndërtimore
- 11) ;
vendosë mbi dhënien me qira, përkatësisht në shfrytëzim të palujtshmërisë në pronësi publike të Komunës, në pajtim me ligjin dhe me rregullën e Komunës;
- 12) ;
vendosë për marrjen dhe disponimin me sendet e luajtshme në pronësi publike të Komunës;
- 13) (,) ;
jep pëlqimin paraprak bartësve të të drejtave të shfrytëzimit ndaj sendeve në pronësi publike të Komunës (bashkësive lokale, enteve dhe organizatave të tjera) për dhënien me qira të atyre sendeve;
- 14) ;
bënë radhitjen e zyrtarëve të qytetit dhe të hapësirave afariste në pronësi publike të Komunës;
- 15) ,
lidhë kontrata në emër të Komunës, në bazë të autorizimeve nga ligji, statuti dhe vendimeve të Kuvendit të komunës;
- 16) ,
në emër të Komunës lidhë kontrata kolektive për organet dhe ndërmarrjet, entet dhe shërbimet e tjera themelues i të cilave është Komuna;
- 17) ;
vendosë mbi organizimin dhe zbatimin e punëve publike;
- 18) ;
lidhë kontratë mbi donacionin nga personat fizik dhe juridik;
- 19) K ,
;
Është komandant i Shtabit komunal për situata të jashtëzakonshme sipas pozitës, nxjerrë vendimin mbi shpalljen dhe heqjen e situatës emergjente me propozim të Shtabit komunal për situata të jashtëzakonshme;
- 20) ;
nxjerr vendimin mbi shpalljen e ditës së zisë në Komunë;
- 21) ;
i aprovon raportet mbi ekzekutimin e buxhetit të Komunës dhe ia dërgon Kuvendit të komunës;
- 22) ;
e informon publikun mbi punën e tij;
- 23) ;
i ushtron ankesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Serbisë, nëse me ndonjë akt të veçantë apo me ndonjë veprim të organeve shtetërore ose të organeve të Komunës pamundësohet ushtrimi i autorizimeve të komunës;
- 24) ;
formon trupa punuese profesionale dhe këshillëdhënëse për punë të caktuara nga kompetenca e vet;
- 25) ;
i cakton dhe i shkarkon ndihmësit e kryetarit të komunës;
- 26) ,
;
nxjerr akte nga kompetenca e Kuvendit komunal në gjendje lufte ose fatkeqësive elementare, me atë që është i obliguar t'ia paraqes Kuvendit për t'i vërtetuar ato në momentin që Kuvendi ka mundësi të mblihet;

Anëtarët e Këshillit komunal nuk mund që të jenë edhe këshilltar, ndërsa mund të caktohen me detyra për një apo më shumë fusha të caktuara nga kompetenca e Komunës.

6)

Këshilltari i cili zgjedhet për anëtar të Këshillit komunal i ndërpritet mandati i këshilltarit.

- K mpetenca

- Neni 68.

- Këshilli komunal:

1)

propozon Statutin, buxhetin, vendimet dhe aktet e tjera të cilat i bie Kuvendi;

2)

drejtëpërsëdrejti ekzekuton dhe kujdeset për ekzekutimin e vendimeve dhe të akteve të tjera të Kuvendit komunal;

3)

bie vendimin për finansimin e përkohshëm në rast se Kuvendi komunal nuk miraton buxhetin para fillimit të vitit fiskal;

4)

kryen mbikqyrjen ndaj punës së Administratës komunale, i anulon ose i heq aktet e Administratës komunale të cilat nuk janë në pajtim me ligjin, Statutin dhe me aktin tjetër të përgjithshëm ose vendimin të cilin e bie Kuvendi komunal;

5)

vendosë në procedurë administrative në shkallë të dytë mbi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, ndërmarrjeve, enteve dhe të organizatave në lëndët administrative nga kompetenca e Komunës;

bie rregulla për elementet e veçanta të vlerësimit të rrezikut dhe të intensitetit të mbikëqyrjes inspektuese në bazë të vlerësimit të rrezikut nga kompetencat burimore të Komunës, si dhe të elementeve të posaçme të planit të caktuar për mbikëqyrje inspektuese nga kompetenca burimore e Komunës;

7)

e përcjellë realizimin e programeve afariste dhe ushtron bashkërendimin e punës së ndërmarrjeve publike themelues i të cilave është Komuna;

8)

paraqet Kuvendit komunal raportin tremujor mbi punën e ndërmarrjeve publike, me qëllim të raportimit të mëtejshëm në pajtim me ligjin me të cilin rregullohet pozita juridike e ndërmarrjeve publike;

9)

i propozon aktet të cilat i njerrë Kuvendi komunal me qëllim të mbrojtjes së interesit të përgjithshëm në ndërmarrjen publike dhe në shoqërinë e kapitalit, ku Komuna është themelues;

10)

vendosë me aktvendim mbi përdorimin e mjeteve të rezervës vijuese dhe të përhershme buxhetore;

11)

kujdeset për ekzekutimin e autorizimeve të besuara nga kuadri i të drejtave dhe obligimeve të Republikës;

12)

e emëron dhe e shkarkon kryeshefin e Administratës komunale;

13)

; e emëron dhe e shkarkon avokatin publik të Komunës;

14)

,
;
E bie Planin e mbrojtjes së Komunës i cili është pjesë përbërëse e Planit të mbrojtjes së Republikës së Serbisë, i harmonizon përgatitjet e mbrojtjes së subjekteve juridike në veprimtaritë nga kompetenca e Komunës me Planin e mbrojtjes së Republikës së Serbisë, bie vendimin mbi organizimin dhe funksionimin e mbrojtjes civile dhe të njësive për dedikim të përgjithshëm;

15)

; bie Vlerësimin e kanosjes dhe Planin për mbrojtje dhe shpëtim në situata të jashtëzakonshme dhe Planin për mbrojtje nga aksidentet;

16)

; e formon komisionin ankimues;

17)

; formon trupa punuese profesionale-këshilldhënëse për punë të caktuara nga kompetenca e vet;

18)

; e njofton publikun për punën e vet;

19)

; e bie rregulloren e punës me propozim të kryetarit të Komunës;

20)

, ushtron edhe punë të tjera, në pajtim me ligjin.

3)

Vendimin nga pika 3 e këtij neni, Këshilli komunal e bie me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit komunal.

Pozita e kryetarit të Komunës në Këshillin komunal

- Neni 69.

Kryetari i Komunës e prezenton Këshillin komunal, i konvokon dhe i udhëheq seancat e tija.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Këshillit komunal.

Kryetari i Komunës është i obliguar ta ndalojë zbatimin e vendimit të Këshillit komunal për të cilin konsideron se nuk është në harmoni me ligjin.

– Kuorumi për punë dhe vendosje

- Neni 70.

Këshilli komunal mund të vendosë nëse në seancë marrin pjesë shumica e anëtarëve nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit komunal.

Këshilli komunal vendosë me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm nëse me ligj apo me këtë statut për çështje të caktuara nuk është paraparë ndonjë shumicë tjetër.

– Rregullorja e punës së Këshillit komunal

- Neni 71.

Organizimi, mënyra e punës dhe e vendosjes së Këshillit komunal, më detajisht rregullohen me

rregulloren e tij, në pajtim me ligjin dhe me këtë statut.

afatit prej gjashtë muaj nga refuzimi i propozimit paraprak.

Raportimi në Kuvendin e komunës

- Neni 72.

Kryetari i komunës mund të paraqes dorëheqje.

Kryetari i Komunës dhe Këshilli komunal janë të obliguar që rregullisht t'i raportojnë Kuvendit të komunës, me vetiniciativë ose me kërkesë të tij, ndërkaq më së paku një herë në vit, mbi ekzekutimin e vendimeve dhe të akteve të tjera të Kuvendit të komunës.

Mbi dorëheqjen e paraqitur të kryetarit të Komunës, kryetari i Kuvendit të komunës i njofton këshilltarët në fillim të seancës së parë të jashtëzakonshme të Kuvendit.

Këshilli komunal është i obliguar t'i raportoj për punën e tij tremujore Kuvendit të Komunës.

Efekti i shkarkimit dhe dorëheqjes së Kryetarit të komunës

- Neni 74.

Shkarkimi dhe dorëheqja e kryetarit të Komunës

- Neni 73.

Me shkarkimin, gjegjësisht dorëheqjen e kryetarit të Komunës i ndërpritet mandati zëvendës kryetarit të Komunës dhe Këshillit komunal.

Kryetari i Komunës mund të shkarkohet para skadimit të mandatit në të cilin është zgjedhur, me propozim të arsyetuar, të së paku 1/3 së këshilltarëve, në të njëjtën mënyrë sikur edhe është zgjedhur.

Shkarkimi dhe dorëheqja e zëvendës kryetarit të Komunës, përkatësisht anëtarit të Këshillit komunal

- Neni 75.

15

43.

3. 5.

Mbi propozimin për shkarkimin e kryetarit të Komunës duhet të diskutohet dhe vendoset në afat prej 15 ditësh nga dita e dërgimit të propozimit kryetarit të Kuvendit të komunës, krahas aplikimit të afatit minimal për konvokimin e seancës nga neni 43. Parag 3 dhe 5 të këtij statuti.

Zëvendësi i kryetarit të Komunës, përkatësisht anëtari i Këshillit komunal, mund të shkarkohet para skadimit të mandatit në të cilin është zgjedhur, me propozim të kryetarit të Komunës ose të së paku një të tretës së këshilltarëve, në mënyrën e njëjtë sikur edhe kur janë zgjedhur.

Nëse Kuvendi nuk e shkarkon kryetarin e Komunës, këshilltarët që kanë paraqitur propozimin për shkarkim nuk mundën që sërish të propozojnë shkarkimin e kryetarit të Komunës para skadimit të

Kryetari i Komunës është i obliguar që krahas propozimit për shkarkimin e zëvendësit të kryetarit të Komunës ose të anëtarit të Këshillit komunal,

Kuvendit komunal t'ia paraqesë propozimin për zgjedhjen e zëvendës kryetarit të ri të Komunës ose të anëtarit të Këshillit komunal, i cili të njëjtën kohë nxjerrë vendimin mbi shkarkimin dhe mbi zgjedhjen.

shkakruar ose që kanë dhënë dorëheqje, mbeten në detyrë dhe i ushtrojnë punët vijuese, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Komunës, zëvendësit të kryetarit të Komunës ose anëtarit të Këshillit komunal.

Ndërprerja e mandatit i organeve ekzekutive të Komunës për shkak të ndërprerjes së mandatit të Kuvendit

- Neni 77.

Në rast se Kuvendi komunale shkarkon zëvendësin e kryetarit të Komunës ose anëtarin e Këshillit komunal me propozim të një të tretës së këshilltarëve, kryetari i Komunës është i obliguar që në seancën e parë të radhës t'ia paraqes Kuvendit të komunës propozimin për zgjedhjen e zëvendësit të ri të kryetarit të komunës, përkatësisht të anëtarit të Këshillit komunal.

Me ndërprerjen e mandatit të Kuvendit komunal i ndërpritet mandati kryetarit të Komunës dhe Këshillit komunal, me atë që ata i ushtrojnë punët vijuese nga kompetenca e vet deri në hyrjen në detyrë të kryetarit të ri të Komunës dhe Këshillit komunal, përkatësisht të kryetarit dhe të anëtarëve të organit të përkohshëm nëse mandati i Kuvendit është ndërprerë për shkak të shpërndarjes së Kuvendit.

Mbi dorëheqjen e paraqitur të zëvendës kryetarit të Komunës ose të anëtarit të Këshillit komunal, kryetari i Kuvendit të komunës i njofton këshilltarët në fillim të seancës së parë të jashtëzakonshme të Kuvendit të komunës.

3. Administrata komunale

- Administrata komunale

- Neni 78.

Në rastin nga parag 4 i këtij neni, kryetari i Komunës është i obliguar që në seancën e radhës së Kuvendit të komunës ta paraqes propozimin për zgjedhjen ezëlvendësit të ri të kryetarit të Komunës, përkatësisht të anëtarit të Këshillit komunal.

Administrata komunale i kryen punët administrative në kuadër të të drejtave dhe obligimeve të Komunës dhe punët e caktuara profesionale dhe administrative – teknike për nevojat e Kuvendit komunal, kryetarit të Komunës dhe Këshillit komunal.

Ushtrimi i punëve vijuese pas ndërprerjes së mandatit për shkak të shkarkimit ose dorëheqjes

– Kompetencat

- Neni 76.

- Neni 79.

– Administrata

komunale:

1)

Kryetari i Komunës, zëvendësi i kryetarit të Komunës ose anëtari i Këshilli komunal të cilët janë

përgaditë rregullat dhe akte tjera të cilat i bie Kuvendi komunal, kryetari i Komunës dhe Këshilli komunal;

- 2) , ;
i ekzekuton vendimet dhe aktet e tjera të Kuvendit komunal, të kryetarit të Komunës dhe të Këshilli komunal;

raporton për ekzekutimin e punëve nga kompetenca e Komunës dhe të punëve të besuara, kryetarit të Komunës, Këshillit komunal dhe Kuvendit komunal, sipas nevojës, por së paku një here në vit.

Parimet e veprimtarisë së Administratës komunale

- 3) ,
;
në procedurë administrative, në shkallë të parë, vendos për të drejtat dhe obligimet e qytetarve, ndërmarjeve, enteve dhe organizatave tjera, në lëndët administrative nga kompetenca e Komunës;

- Neni 80.

Administrata komunale vepron sipas rregullave profesionale, me paanshmëri dhe politikisht neutrale dhe është e obliguar që secilit t'i mundësoj mbrojtje të njëjtë juridike në realizimin e të drejtave, detyrimeve dhe interesave juridike.

- 4) ;
kryen punët e mbikqyrjes administrative ndaj ekzekutimit të rregullave dhe të akteve të tjera të përgjithshme të Kuvendit komunal;

Administrata komunale është e obliguar që t'iu mundësoj qytetarëve realizim të shpejtë dhe efikas të të drejtave dhe interesave të tyre juridike.

- 5) ;
ekzekuton ligjet dhe rregullat e tjera ekzekutimi i të cilave i është besuar Komunës;

Administrata komunale është e obliguar që qytetarëve t'ia jep të dhënat dhe njoftimet e nevojshme dhe t'iu ofroj ndihmë juridike.

- 6) ;
mbanë evidenca të parapara me ligj dhe kujdeset për mirëmbajtjen e tyre;

Administrata komunale është e obliguar që të bashkëpunoj me qytetarët dhe ta rrespektoj personalitetin dhe dinjitetin e qytetarëve.

- 7) -
;
kryen punë profesionale dhe administrative – teknike për nevojat e punës së Kuvendit komunal, kryetarit të Komunës dhe Këshillit komunal;

- 8) -
;
i ofron ndihmë bashkësive lokale në kryerjen e punëve administrative – teknike dhe finansiare – materiale;

Kur organet e Komunës vendosin mbi të drejtat, obligimet ose interesat juridike të subjektit fizik apo juridik, përkatësisht të palës tjetër, sipas detyrës zyrtare Administrata komunale bën mbikqyrjen, i siguron dhe i përpunon të dhënat nga evidencat, përkatësisht regjistrat të cilat në pajtim me rregullat e veçanta i mbajnë organet shtetërore,

- 9) ,
,
.

organet e autonomisë territoriale, njësitë e vetëadministrimit lokal dhe poseduesit e autorizimeve publike, në pajtim me ligjin.

5.

Qasja, gjetja dhe përpunimi i të dhënave nga evidencat, përkatësisht regjistrat që mbahen në formë elektronike në procedurën nga paragrafi 5 i këtij neni, bëhen përmes sistemit informativ i cili garanton siguri dhe mbrojtjen e të dhënave mbi personin.

5.

Në procedurën nga paragrafi 5 i këtij neni Administrata komunale mund të bëjë shikimin, marrjen dhe t'i përpunojë vetëm ato të dhëna të cilat me ligj ose me rregull të veçantë të përcaktuara si të domosdoshme për zgjidhjen mbi të drejtën, obligimin ose interesin juridik të caktuar.

Organizimi i Administratës komunale

- Neni 81.

Administrata komunale organizohet si organ unik.

Në Administratën komunale formohen njësitë e brendshme organizative për ushtrimin e punëve simotra administrative, profesionale dhe punëve të tjera.

- Udhëheqja

- Neni 82.

Me administratën komunale udhëheq kryeshefi.

Për kryeshef të Administratës komunale mund të caktohet personi i cili e ka arsimin superior nga sfera shkencore e shkencave juridike në studimet themelore akademike në vëllim prej së paku 240 ECTS pikë, në studimet akademike master, në studimet specialistike akademike, në studimet profesionale specialistike, përkatësisht në studimet themelore në kohëzgjatje prej së paku katër vjetë ose në studimet specialistike në fakultet, së paku pesë vjet pune në profesion dhe ta ketë të dhënë provimin profesional për punë në organet e administratës shtetërore.

Caktimi i kryeshefit dhe zëvendësit të kryeshefit të Administratës komunale

- Neni 83.

Kryeshefin e Administratës komunale e cakton Këshilli komunal, në bazë të konkursit publik, me mandat pesë vjeçar.

Kryeshefi i Administratës komunale mund të ketë zëvendësin i cili e zëvendëson në rastet kur mungon dhe është i penguar në kryerjen e detyrës së tij.

Zëvendësi i kryeshefit të Administratës komunale caktohet në mënyrën si edhe kryeshefi i administratës komunale.

Drejtuesit e njësive organizative në Administratë i radhit kryeshefi i Administratës komunale.

- Përgjegjësitë e kryeshefit

- Neni 84.

4)

;
të jap urdhëresa të përkohëshme,
përkatësisht ndalesë;

Për punën e tij dhe të punës së Administratës komunale, Kryeshefi i përgjigjet Kuvendit komunal dhe Këshillit komunal në pajtim me këtë Statut dhe me Vendimin mbi administratën komunale.

5)

;
ta lajmëroj organin tjetër, nëse për këtë ka arsye, për ndërmarrjen e masave për të cilat ai organ është kompetent;

**- Rregullimi i
Administratës komunale**

- Neni 85.

6)

Vendimin mbi administratën komunale e bie Kuvendi komunal me propozim të Këshillit komunal.

të ndërmarrë edhe masa të tjera për të cilat ka autorizime ligjore, me rregulla ose me akt të përgjithshëm;

Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe të sistematizimit të Administratës komunale, të organeve, shërbimeve dhe organizatave të veçanta i përbashkon Kryeshefi i Administratës komunale dhe ia dërgon Këshillit komunal për miratim.

1.

Autorizimet dhe organizimi për kryerjen e punëve nga paragrafi 1 i këtij neni, më për së afërmi rregullohen me vendimin e Kuvendit komunal.

Zbatimi i rregullave në procedure administrative

- Neni 87.

**Autorizimet gjatë ushtrimit të mbikqyrjes
administrative**

- Neni 86.

Administrata komunale në ushtrimin e mbikqyrjes administrative mund të:

1)

;
urdhëroj me aktvendim ekzekutimin e masave dhe të veprimeve në afat të caktuar;

2)

;
të shpitoj gjoba në të holla;

3)

;
t'i paraqesë fletëparaqitje organit kompetent për veprën e kryer penale apo për kundravajtje ekonomike dhe të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje;

Në procedure në Administratën komunale, në të cilën vendoset mbi të drejtat, obligimet dhe interesat e qytetarëve dhe të personave juridik zbatohen rregullat mbi procedurën Administrative.

- Konflikti i kompetencave

- Neni 88.

Këshilli komunal i zgjidh konfliktin e kompetencave në mes të Administratës komunale dhe të ndërmarrjeve, organizatave dhe të enteve të tjera kur me vendimin e Kuvendit komunal vendoset mbi të drejtat dhe detyrimet e caktuara të qytetarëve, të personave juridik apo të palëve të tjera.

Kryeshefi administratës komunale zgjidh konfliktin e kompetencave në mes të njëjësive të brendshme organizative.

V.

Kushtet për kryerjen e punëve administrative

- Neni 89.

Punët e Administratës komunale të cilët kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave dhe të detyrimeve dhe të interesave të qytetarëve dhe të personave juridik mund t'i kryejnë personat të cilët kanë përgatitje të paraparë shkollore, ta kenë të kryer provimin profesional për punë në organet e administratës shtetërore dhe përvojë të caktuar të punës, në pajtim me ligjin dhe me rregullat e tjera.

-Përjashtimi

- Neni 90.

Mbi përjashtimin e kryeshefit të Administratës komunale vendos Këshilli komunal.

Mbi përjashtimin e personit zyrtar në Administratën komunale vendosë kryeshefi.

4. Avokatura komunale

- Neni 91.

Punët e mbrojtjes juridike të të drejtave pronësore dhe interesave të Komunës i ushtron Avokatia komunale.

Forimimi, rregullimi dhe organizimin si dhe çështjet e tjera me rëndësi për punën e Avokatisë komunale, përcaktohet me vendimin e Kuvendit të komunës në pajtim me bazat për rregullimin dhe organizimin e avokatisë të parapara me ligj.

PJESËMARRJA E DREJTËPËRDREJTË E QYTETARËVE NË REALIZIMIN E VETËADMINISTRIMIT LOKAL

Format e pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë të qytetarëve

- Neni 92.

Qytetarët e komunës, drejtëpërsëdrejti marrin pjesë në realizimin e punëve të Komunës, nëpërmjet nismave qytetare, tubim të qytetarëve si dhe referendum.

- Nisma qytetare

- Neni 93.

Qytetarët përmes nismës qytetare i propozojnë Kuvendit komunal aprovimin e aktit me të cilin rregullohet ndonjë çështje e caktuar nga kompetenca e Komunës, ndryshimin e statutit apo të akteve të tjera dhe të shpalljes së referendumit në pajtim me ligjin.

Administrata komunale është e obliguar të ofrojë ndihmë profesionale qytetarëve me rastin e formulimit të propozimit të nismës qytetare.

5%

Nisma qytetare është e juridikisht e vlefshme nëse lista e nënshkruesve të nismës qytetare është përpiluar në pajtim me ligjin dhe nëse listen e kanë nënshkruar së paku 5% e qytetarëve me të drejtë vote.

1. -

Për propozimin nga alinea 1. e këtij neni, Kuvendi komunal është i obliguar që të mbajë debat dhe të dërgoj përgjigje të arsyetuar qytetarëve në afat prej 60 ditësh nga dita e marrjes së propozimit.

– Tubimi i qytetarëve

- Neni 94.

Tubimi i qytetarëve debaton dhe jep propozime mbi çështjet nga kompetenca e organeve të Komunës.

- Konvokimi i tubimit

– Neni 95.

Tubimi i qytetarëve konvokohet për vendbanimin apo për një pjesë të vendbanimit, i cili mund të jetë: lagje, rrugë, pjesë e qytetit, trevë e bashkësisë lokale ose të formës tjetër të vetëadministrimit vendor.

Tubimine qytetarëve e konvokon kryetari i Komunës, kryetari i Kuvendit komunal, përfaqësuesi i autorizuar i bashkësisë lokale ose të formës tjetër të vetëadministrimit vendor, së paku 50 qytetarë me vendbanim në trevën për të cilën konvokohet tubimi dhe më së paku një e katërta e këshilltarëve, më së paku tetë ditë para ditës së mbajtjes së tubimit.

Administrata komunale është e obliguar të ofrojë ndihmë konvokuesit në konvokimin dhe përgatitjen e mbajtjes së tubimit të qytetarëve.

Propozimin për konvokimin e tubimit mund ta udhëzojë organi i komunës kompetent për çështjen e cila shqyrtohet në tubim.

Për tubimin e konvokuar, qytetarët informohen përmes vendosjes së aktit mbi konvokimin e tubimit në faqen zyrtare të komunës në internet, në tabelën e shpalljeve të Komunës, përmes mjeteve të informimit ose edhe në formë tjetër të zakonshme.

Konvokuesi është i obliguar ta informojë Administratën komunale mbi mbajtjen e tubimit.

Puna e tubimit dhe certifikimi i qëndrimeve të tubimit

- Neni 96.

Tubimin e qytetarëve e kryeson konvokuesi ose personi të cilin ai e autorizon.

5%

Tubimi i qytetarëve i shqyrton propozimet dhe merr qëndrime për ato nëse në tubim marrin pjesë 5 % e qytetarëve me të drejtë vote, nga treva për të cilën është konvokuar tubimi.

Të drejtën e pjesëmarrjes në shqyrtimin, iniciimin dhe propozimin e zgjidhjeve të caktuara, e kanë të gjithë qytetarët e moshës madhore të Komunës.

Të drejtën e vendosjes në tubimin e qytetarëve e kanë edhe qytetarët vendbanimi ose pasuria e të cilëve gjendet në trevën për të cilën është konvokuar tubimi.

Vendimet në tubimin e qytetarëve miratohen me shumicën e qytetarëve të pranishëm me të drejtë vendosjeje.

Administrata komunale është e obliguar që të ofrojë ndihmë profesionale qytetarëve me rastin e formulimit të propozimit, përkatësisht të kërkesave nga tubimi i qytetarëve, para dërgimit të tyre në organet kompetente të Komunës.

Mënyra e punës dhe mënyra e përcaktimit të qëndrimeve të tubimit rregullohet me vendimin e Kuvendit komunal.

Procedimi i organit kompetent të Komunës pas tubimit të mbajtur

- Neni 97.

60

Organet e Komunës janë të obliguara që në afat prej 60 ditësh, nga dita e mbajtjes së tubimit të qytetarëve, t'i shqyrtojnë kërkesat dhe propozimet e qytetarëve, të marrin qëndrim për ato, përkatësisht të nxjerrin vendim përkatës ose masë dhe për këtë t'i informoj qytetarët.

- Referendumi

- Neni 98.

Kuvendi komunal mundet që me iniciativë të vet, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve, të shpallë referendum për çështjet nga fushëveprimi i vet.

Kuvendi komunal është e obliguar ta shpallë referendumin për çështje nga fushëveprimi i tij me kërkesë të qytetarëve të komunës.

2.

10%

Kërkesa e qytetarëve nga parag. 2. i këtij neni është e fuqiplotë nëse lista e nënshkruesve të kërkesës është përpiluar në pajtim me ligjin dhe nëse të njëjtën

e kanë nëshkruar më së paku 10 % e qytetarëve me të drejtë vote në territorin e Komunës.

Vendimi përmes referendumit është miratuar nëse për këtë janë deklaruar shumica e qytetarëve me të drejtë vote në territorin e Komunës që ka votuar, me kusht që të kenë votuar më shumë se gjysma nga numri i përgjithshëm i qytetarëve me të drejtë vote në territorin e Komunës.

Vendimi i miratuar në referendum është obligativ, ndërkaq Kuvendi komunal nuk mund ta shfuqizoj, e as që me ndryshime dhe plotësime ta ndryshoj thelbin e saj në periudhën prej një viti nga dita e nxjerrjes së vendimit.

Referendumi në një pjesë të territorit të Komunës

- Neni 99.

10%

Kuvendi komunal është i obliguar që ta shpallë referendumin në pjesën e territorit të Komunës për çështjen e cila ka të bëjë me nevojat, përkatësisht interesat e banorëve të asaj pjese të territorit, nëse lista e nënshkruesve të kërkesës për shpalljen e referendumit është përpiluar në pajtim me ligjin dhe nëse atë e kanë nëshkruar së paku 10% e zgjedhësve sipas publikimit të fundit të aktvendimit mbi përmbylljen e regjistrit zgjedhor për zgjedhjen e këshilltarëve të Kuvendit komunal, nga pjesa e territorit të Komunës për të cilën kërkohet shpallja e referendumit.

- peticioni i qytetarëve

- Neni 100.

Peticioni është formë e shkruar që individi ose grupi i qytetarëve me vendbanim në territorin e Komunës së Bujanocit me të cilën nga organi i caktuar i Komunës kërkojnë iniciimin e procedurës ose ndërmarrjen e masave ose veprimeve nga kompetenca e tyre.

Peticioni duhet të përmbajë patjetër:

- 1) Emërtimi i organit të cilit i drejtohet,
- 2) Baza juridike për ushtrimin e peticionit me kërkesën që t’i përgjigjen peticionit,
- 3) Kërkesë përkatësisht propozimi i ushtruesit i formuluar qartë, me arsyetim,
- 4) Emri, mbiemri dhe venbanimi i ushtruesit të peticionit dhe
- 5) Nënshkrimi i ushtruesit të peticionit.

30

Organi i Komunës të cilit iu është drejtuar peticioni është i obliguar që në afat prej 30 ditësh nga dita e dërgimit, ta njoftoj ushtruesin e peticionit mbi qëndrimin e tij ndaj kërkesës, përkatësisht propozimeve që përmbanë peticioni.

Administrata komunale është e obliguar të i ofrojë qytetarëve ndihmën profesionale në formulimin e peticionit si dhe t’ia ofroj të dhënat dhe njoftimet e nevojshme me rëndësi për formulimin e kërkesës së arsyetuar, përkatësisht të propozimeve të peticionit.

– Ankesat e qytetarëve

- Neni 101.

Organet e Komunës janë të obliguara që qytetarëve t’iu mundësojnë ankesat ndaj punës së saj dhe ndaj punës jo të rregullt të punonjësve në Administratën komunale dhe të raportit të tyre ndaj qytetarëve.

Organet e Komunës janë të obliguara që t’i shqyrtojnë thekset e paraqitura në ankesë, të cilët tregojnë për lëshimet dhe jorregullshmëritë në punën e tyre dhe që në pajtim me ligjin të iniciojnë procedurën përkatëse për sanksionimin dhe mënjanimin e lëshimeve dhe të parregullshmërive.

30

Organet e Komunës janë të obliguara që bartësit të ankesës t’i japin përgjigje dhe informata se a është dhe si është vepruar ndaj ankesës, në afat prej 30 ditësh , nëse këtë e kërkon bartësi i ankesës.

VI.

FORMAT E TJERA TË PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË PUNËT E KOMUNËS

o – Këshilli për zhvillimin e komunës

- Neni 102.

Themelohet Këshilli për zhvillimin e komunës si trup i pavarur punues

– Këshilli për zhvillimin e komunës:

- 1) inicion përcaktimin e përparësive në sferën e zhvillimit të Komunës;

2)

- merrë pjesë në hartimin e planeve strategjike dhe individuale të zhvillimit në fushat me rëndësi për zhvillimin e Komunës;
- 3) jep mendimin mbi propozimet e projekteve zhvillimore në komunë të cilët pjesërisht ose plotësisht financohen nga buxheti i Komunës, e përcjellë realizimin e tyre dhe ia jep mendimin e vet mbi të, organit kompetent të Komunës;
- e stimulon zhvillimin dhe e përcjell partneritetin mes Komunës dhe organeve kompetente dhe organizatave, bashkësive lokale dhe shoqatave të qytetarëve, me qëllim të krijimit dhe të zbatimit të projekteve zhvillimore;
- 4) Në bazë të vendimit të organit kompetent të Komunës merrë pjesë në programet dhe projektet partnere të cilat i zbaton Komuna me organet dhe entet republikane dhe krahinore, njësitë e vetëadministrimit lokal dhe me organizatat dhe partnerët vendor e ndërkombëtarë.
- 5) **Përbërja dhe mandati i Këshillit për zhvillim të komunës**
- Neni 103.
Këshilli për zhvillimin e Komunës i ka shtatë anëtarë.
Anëtarë të Këshillit për zhvillimin e Komunës zgjedhen për periudhë katërvjeçare, ndërkaq mund të rizgjedhen pas skadimit të mandatit.
- 6) i propozon modelet e financimit të aktiviteteve në sferën e politikës sociale, arsimit, mbrojtjen shëndetsore, punësimit, zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe në sferat e tjera me rëndësi për zhvillimin e Komunës;
- 7) Anëtarët e Këshillit për zhvillimin e komunës i zgjedhë Kuvendi komunal nga radhët e qytetarëve dhe ekspertëve në sfera me rëndësi për vetadministratën lokale, me propozim të kryetarit të Komunës, Këshillit komunal, grupeve të këshilltarëve, bashkësive lokale, shoqatave qytetare, shoqatave profesionale dhe të esnafëve, ose të shërbimeve publike të Komunës, duke u kujdesur mbi
- 8) inicicion përgatitjen e projekteve ose pjesëmarrjen në programe ose projekte me qëllim të përparimit të zhvillimit të Komunës;

barazinë e poleve dhe të përfaqësimit të pjesëtarëve të pakicave nacionale.

Për anëtar të Këshillit për zhvillimin e komunës mund të zgjedhet kandidati i cili i plotëson së paku njërin nga këto kushte:

1)

profesionalizmin e dëshmuar në angazhimin shumëvjeçar në avansimin e Komunës në çështjet me rëndësi për zhvillimin e Komunës;

2)

pjesëmarrje aktive në shumicën e aktiviteteve - projekteve të realizuara të rëndësishëm për Komunën;

3)

Përvojë shumëvjeçare dhe ekspertizë të dëshmuar në punën profesionale në ente, organizata dhe shoqatat e qytetarëve në sferat me rëndësi për Komunën, siç janë: zhvillimi ekonomik lokal, turizmi, bujqësia, infrastruktura komunale dhe zhvillimi urbanistik, kultura, arsimit, mbrojtja shëndetësore dhe sociale e tj.

Mënyra e punës së Këshillit për zhvillimin e komunës

- Neni 104.

Kryetari i Këshillit për zhvillimin e komunës e organizon punën e tij, i konvokon dhe i kryeson seancat, realizon bashkëpunim me organet e Komunës, dhe i ushtron punët e tjera të përcaktuara me rregulloren e Këshillit për zhvillimin e komunës.

Kryetarin e Këshillit për zhvillimin e komunës e zgjedhin anëtarët e këtij Këshilli në pajtim me rregulloren e Këshillit për zhvillim të komunës.

15

a

Seancat e Këshillit për zhvillim të komunës i konvokon kryetari i Këshillit, së paku një herë në tre muaj ose me kërkesë të shkruar të organit të Komunës ose të një të tretës së anëtarëve të Këshillit për zhvillim të komunës në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Punët profesionale dhe administrative lidhur me punën e Këshillit për zhvillim të komunës i kryen Administrata komunale.

Mjetet për punën e Këshillit për zhvillim të komunës sigurohen nga buxheti i Komunës, ndërsa mund të sigurohen edhe nga burime të tjera, në pajtim me ligjin.

Mënyra e punës së Këshillit për zhvillim të komunës detajizohet me rregulloren e Këshillit për zhvillim të komunës.

- Anketa publike

- Neni 105.

Organet e Komunës mund t'i konsultojnë qytetarët mbi çështjet nga kompetenca e vet.

1.

Konsultimet nga paragrafi 1 i këtij neni bëhen përmes anketës publike.

- Diskutimi publik

- Neni 106.

Diskutimi publik detyrimisht përfshinë një set të aktiviteteve të ndryshme, që ndërmerren në kornizën kohore paraprakisht të caktuar, me qëllim të grumbullimit të propozimeve dhe qëndrimeve të qytetarëve mbi draftin e ndonjë akti.

Organi kompetent i Komunës është i obliguar që në faqen zyrtare të Komunës në internet, përkatësisht në një mënyrë tjetër të përshtatshme ta njoftoj opinionin se ka filluar puna në përgatitjen e rregullave të cilat i bie kuvendi.

- Diskutimi publik i obligueshëm

- Neni 109.

Organet e Komunës janë të obliguara të mbajnë diskutime publike:

Diskutimi publik përfshinë patjetër organizimin e së paku një takimi të hapur të përfaqësuesve të organeve kompetente të Komunës, përkatësisht shërbimeve publike me qytetarët e interesuar, përfaqësuesit e shoqatave të qytetarëve dhe mjeteve të informimit publik (tryezat e rrumbullakëta, tribunat, prezentimet e tj.) dhe grumbullimit të propozimeve, sugjerimeve dhe mendimeve të qytetarëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë në diskutimin publik në formë të shkruar ose elektronike.

- 1) ;
në procedurën e përgatitjes së statutit;
- 2) a ()
në procedurën e përgatitjes së Buxhetit (në pjesën e planifikimit të investimeve);
- 3) ;
në procedurën e përgatitjes së planeve strategjike zhvillimore;
- 4) ;
në procedurën e përcaktimit të normës së të hyrave burimore të Komunës;
- 5) ;
në procedurën e përgatitjes së planeve hapsinore dhe urbanistike;
- 6) ;
Dhe në rastet e tjera të parapara me ligj dhe me statutin e Komunës..

Organi kompetent për organizimin e diskutimit publik shtë i obliguar që qytetarëve nga të gjitha pjesët e Komunës t'iu mundësoj pjesëmarrje në diskutimin publik.

Mënyra dhe procedura e organizimit dhe realizimit të diskutimit publik në detaje rregullohet me vendimin e veçantë të Kuvendit të komunës.

- Kohëzgjatja e diskutimit publik

- Neni 107.

Diskutimi publik zgjatë së paku 15 ditë.

Publikimi i fillimit të punës në përgatitjen e diskutimit

- Neni 108.

Diskutimi publik nga parag 1 i këtij neni zbatohet mbi draftet e akteve (vendimeve, planeve dhe aktit tjetër gjatë përgatitjes), ndërkaq mund të zbatohet edhe më herët me propozim të organit kompetent për përgatitjen dhe përcaktimin e draftit.

109. 4.

Diskutimin publik nga paragrafi 1 i këtij neni e organizon Këshilli komunal në mënyrën dhe kohën të cilën e propozon organi kompetent për përcaktimin e draftit, nëse me këtë statut ose me vendim të veçantë nga neni 109 paragrafi 4 i këtij statuti nuk është caktuar ndryshe.

Diskutimi publik në bazë të propozimit, përkatësisht kërkesës

- Neni 110.

100

Diskutimi publik mund të zbatohet në procedurën e nxjerrjes së akteve të tjera të përgjithshme nga kompetenca e Kuvendit komunal, në bazë të kërkesës së propozuesit të aktit të përgjithshëm, një të tretës së këshilltarëve ose me propozim të 100 qytetarëve.

100

Me qëllim të zbatimit të diskutimit publik, propozimi i qytetarëve nevojitet që të mbështetet me nënshkrimin e së paku 100 qytetarëve me të drejtë zgjedhore në territorin e Komunës.

1.

Grumbullimi i nënshkrimeve të qytetarëve për zbatimin e diskutimit publik nga paragrafi 1 i këtij neni, zbatohet në pajtim me rregullat të cilat e rregullojnë nismën qytetare.

1.

Trupi punues kompetent i Kuvendit komunal, vendosë sipas propozimit të përgatitur, përkatësisht sipas kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni.

1.

Nëse trupi punues kompetent i Kuvendit të komunës e aprovon propozimin, përkatësisht kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni, Këshilli komunal organizon diskutimin publik, sipas rregullit, në mënyrën dhe kohën të cilat janë propozuar në parashtrësë.

– Organizimi i diskutimit publik

- Neni 111.

Këshilli komunal e organizon diskutimin publik, e cakton mënyrën e zbatimit, vendin dhe kohën e zgjatjes së diskutimit publik.

Këshilli komunal ia drejton ftesën publike qytetarëve, shoqatave, opinionit profesional dhe të tjerëve, për pjesëmarrje në diskutim publik.

Ftesa publike për pjesëmarrje në diskutimin publik, shpallet në prezantimin e Komunës në internet dhe në mënyrë tjetër të përshtatshme. Krahas ftesës publike duhet patjetër të publikohet programi i zbatimit të diskutimit publik si dhe drafti i aktit i cili është lëndë e këtij diskutimi publik.

Këshilli komunal mund t'ia drejtoj ftesën për pjesëmarrje individëve të caktuar, präfaqësuesve të organeve, organizatave dhe shoqatave për të cilët mendon se janë të interesuar për aktin i cili pritet të shqyrtohet.

Mbi rrjedhën e diskutimit publik përpilohet raport i cili përmbanë të gjitha propozimet dhe sugjerimet nga diskutim publik, si dhe qëndrimet e organit kompetent për përgatitjen e aktit mbi propozimet dhe sugjerimet e parashtruara me

arsyetimin e shkaqeve për aprovimin ose refuzimin e tyre.

5. o

Raporti nga parag 5 i këtij neni publikohet në prezentimin e Komunës në internet dhe në mënyrë tjetër të përshtatshme.

Përcaktimi i propozimit të aktit pas diskutimit të zbatuar

- Neni 112.

Organi kompetent për përcaktimin e propozim aktit mbi të cilin është zbatuar diskutimi publik, është i obliguar që me rastin e përcaktimit të propozim aktit të ketë kujdes për sugjerimet dhe propozimet e dhëna në diskutimin publik.

VII. VETËADMINISTRIMI VENDOR

– Format e vetëadministrimit vendor

- Neni 113.

Me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe interesave jetike për qytetarët e një zone të caktuar, në Komunë formohen bashkësi lokale dhe forma të tjera të vetëadministrimit vendor.

Bashkësia lokale formohet për një apo më shumë fshatra.

Bashkësia lokale, apo forma tjetër e vetëadministrimit vendor (në vazhdim të tekstit:

bashkësia lokale) themelohet për: vendbanim, dy e më shumë vendbanime, pjesë të vendbanimit, kuart qyteti, regjion, bllok banesor, rrugë, pjesë të një rrugë apo më shumë rrugë, që paraqet tërësinë hapsinore, funksionale dhe urbanistike dhe ku ekziston lidhja e interesit ndërsjellë të qytetarëve dhe mundësia e organizimit të tyre.

– Statusi juridik i bashkësisë lokale

- Neni 114.

Bashkësia lokale e ka statusin e personit juridik në kuadër të të drejtave dhe detyrimeve të parapara me këtë statut dhe me vendimin themelues.

Bashkësia lokale e ka vulën dhe llogarinë e saj.

– Pasuria e bashkësisë lokale

- Neni 115.

Bashkësia lokale e ka pasurinë e vet të cilën mund ta përbëjnë: sendet e luajtshme, paratë sikur edhe të drejtat dhe obligimet.

Bashkësia lokale ka të drejtën e shfrytëzimit të palujtshmërive që janë në pronësi publike të Komunës.

Propozimi për formimin, përkatësisht heqjen e bashkësisë lokale

- Neni 116.

10%

Propozimin për formimin, përkatësisht heqjen e bashkësisë lokale mund ta parashtrajnë së paku 10% e zgjedhësve me vendbanim në zonën me të cilën përkon propozimi, së paku një e treta e këshilltarëve dhe Këshilli komunal.

Pas marrjes së mendimit paraprak të qytetarëve, Kuvendi komunalvendosë për formimin, zonën për të cilën formohet, ndryshimin e zonës dhe heqjen e bashkësive lokale.

Bashkësia e re lokale formohet me bashkimin e dy ose më shumë bashkësive lokale ekzistuese ose të ndarjes së një pjese të zonës nga një ose më shumë bashkësi lokale ekzistuese në bashkësi të re lokale.

Me ndryshimin e zonës së bashkësisë lokale konsiderohet edhe ndryshimi i kufijve të zonës, nëse me ndryshimin e kryer një pjesë e zonës së një bashkësie lokale i bashkohet bashkësisë tjetër lokale.

2.

Vendimi nga parag 2 bihet me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve.

– Vendimi mbi bashkësitë lokale

- Neni 117.

juridik i bashkësisë lokale, pasuria e bashkësisë lokale, të drejtat dhe detyrimet e bashkësisë lokale, numri i anëtarëve të Këshillit, kompetencat e Këshillit, procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit, shpërndarja e këshillit të bashkësisë lokale, ndërprerja e mandatit të anëtarëve të Këshillit të bashkësisë lokale, financimi i bashkësisë lokale, pjesëmarrja e qytetarëve në ushtrimin e punëve të bashkësisë lokale, bashkëpunimi i bashkësisë lokale me bashkësitë e tjera lokale, procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të bashkësisë lokale, si dhe çështjet e tjera me rëndësi për punën dhe funksionimin e bashkësive lokale në territorin e Komunës.

– Këshilli i bashkësisë lokale

- Neni 118.

Këshilli i bashkësisë lokale është organi themelor përfaqësues i qytetarëve në zonën e vetëadministrimit vendor.

Zgjedhjet për bashkësi lokale zbatohen sipas rregullave të votimit të drejtëpërdrejtë dhe të fshehtë në bazë të të drejtës së përgjithshme dhe të barabartë zgjedhore, në pajtim me aktin themelues.

4

Mandati i anëtarëve të Këshillit të bashkësisë lokale zgjatë 4 vjet.

Zgjedhjet për këshillin e bashkësisë lokale i shpallë kryetari i Kuvendit të komunës.

Kryetarin e këshillit të bashkësisë lokale e zgjedhë këshilli nga radhët e veta, me votim të fshehtë, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit të bashkësisë lokale.

Këshilli i bashkësisë lokale:

Me vendimin mbi bashkësitë lokale rregullohet formimi, përkatësishtë heqja ose ndryshimi i hapësirës së bashkësisë lokale, statusi

1. ;
e bie statutin e bashkësisë lokale

2. **- Neni 119.**

;

e bie planin financiar të bashkësisë lokale dhe programin e zhvillimit të bashkësisë lokale;

3. Këshilli i bashkësisë lokale mund të shpërndahe nëse:

;

e zgjedhë dhe e shkarkon kryetarin e këshillit të bashkësisë lokale;

1) ;
këshilli nuk takohet më gjatë se tre muaj;

4. 2)

;

i propozon masat për zhvillimin dhe avansimin e veprimtarive komunale dhe të tjera në zonën e bashkësisë lokale;

5. nuk e zgjedhë kryetarin e këshillit në afatin prej një muaj nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve për anëtarë të bashkësisë lokale ose nga dita e shkarkimit të tij, ose të dorëheqjes;

;

bie rregulloren e punës së këshillit të bashkësisë lokale dhe aktet etjera nga kompetenca e bashkësisë lokale;

3)
Nuk sjell planin financiar në afatin e paraparë me vendimin e Kuvendit të komunës.

6. ;
inicon nismën për nxjerrjen e rregullave të reja të Komunës ose ndryshimin e atyre ekzistuese;

7. ,
Vendimin mbi shpërndarjen e këshillit të bashkësisë lokale e bie Kuvendit i komunës me propozim të Këshillit komunal i cili mbikqyr ligjshmërinë e punës dhe akteve të bashkësisë lokale.

Kryen punë të tjera nga kompetenca e bashkësisë lokale të përcaktuara me statutin e Komunës, me aktin e themelimit të bashkësisë lokale ose me rregullat e tjera të Komunës;

15

45

Kryetari i Kuvendit komunal i shpallë zgjedhjet për këshillin e bashkësisë lokale, në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit mbi shpërndarjen e këshillit të bashkësisë lokale, me atë që afati nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e mbajtjes së tyre nuk mund të jetë më shumë se 45 ditë.

Këshilli i bashkësisë lokale është i obliguar që mbi pasurinë e bashkësisë lokale, si dhe me palujtshmëritë në pronësi publike të Komunës në të cilat ka të drejtën e shfrytëzimit, ta administroj dhe të disponoj në pajtim me ligjin, vendimet e Kuvendit të komunës dhe me Statutin e bashkësisë lokale.

Angazhimi i kryetarit dhe i anëtarëve të këshillit, si dhe i anëtarëve të organeve të tjera të bashkësisë lokale nuk nënkupton krijimin e obligimeve shtesë për bashkësinë lokale.

Deri në konstituimin e këshillit të bashkësisë lokale, punët vijuese dhe të pashtyeshme të bashkësisë lokale i ushtron i ngarkuari i Komunës të cilin e emëron Kuvendi komunal krahas nxjerrjes së vendimit mbi shpërndarjen e këshillit të bashkësisë lokale.

– **Financimi i**

bashkësisë lokale

Shpërndarja e bashkësisë lokale

- Neni 120.

Mjetet për punën e bashkësisë lokale sigurohen nga:

1. mjetet e parapara me vendimin mbi buxhetin e komunës, përfshirë edhe vetkontributin,
2. donacionet dhe
3. Të hyrat të cilat bashkësia lokale i realizon përmes aktiviteteve të veta.

Bashkësia lokale e bie planin financiar ndaj të cilit pëlqimin e jep Këshilli komunal, në pajtim me vendimin mbi buxhetin e Komunës.

Ngarkimi me punë i bashkësisë lokale dhe Organizimi i punës së administratës në bashkësitë lokale.

- Neni 121.

Me vendim të Kuvendit bashkësisë lokale dhe ose formave të tjera të vetëadministrimit vendor mund t'i besohet kryerja e punëve të caktuara nga kompetenca e Komunës krahas sigurimit të mjeteve.

- 1.

Gjatë vendosjes mbi besimin e punëve nga paragrafi 1 i këtij neni si bazë shërben rëndësia e atyre punëve në përmbushjen e nevojave të përditshme dhe të drejtëpërdrejta të qytetarëve nga zona përkatëse.

Për ushtrimin e punëve të caktuara nga kompetenca e Administratës komunale, veçmas lidhur me realizimin e të drejtave të qytetarëve, mund të organizohet puna e administratës në bashkësi lokale.

- 3.

Punët nga paragrafi 3 i këtij neni, mënyra dhe vendi i ushtrimit të tyre, i cakton kryetari i komunës, me propozim të kryeshefit të Administratës komunale.

Ndihma profesionale në ushtrimin e punëve të bashkësisë lokale

- Neni 122.

Administrata komunale është e obliguar që bashkësive lokale t'iu ofroj ndihmë në ushtrimin e punëve administrative – teknike dhe finansiare – materiale.

Procedura për vlerësimin e kushtetshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të përgjithshëm të bashkësisë lokale

- Neni 123.

Këshilli komunal do të inicioj procedurën për vlerësimin e kushtetshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të bashkësisë lokale para Gjykatës kushtetuese, nëse konsideron se ai akt nuk është në përputhje me Kushtetutën ose ligjin.

Kryetari i komunës është i obliguar që ta ndaloj ekzekutimin e aktit të përgjithshëm të bashkësisë lokale për të cilin konsideron se nuk është në përputhje me Kushtetutën ose ligjin, me aktvendim i cili hynë në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën zyrtare të komunës së Bujanocit.

Aktvendimi mbi ndalesën e ekzekutimit shfuqizohet nëse Këshilli komunal në afat prej pesë ditësh nga publikimi i aktvendimit nuk e inicon vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit.

Të këshilluarit e bashkësive locale për ndërmarrjen e masave përkatëse

- Neni 124.

Kur Këshilli komunal konsideron se akti i përgjithshëm i bashkësisë lokale nuk është në përputhje me statutin e Komunës, me aktin për themelimin e bashkësisë lokale ose me ndonjë rregull tjetër komunale, këshilli i bashkësisë lokale do të këshillohet të ndërmerr masa përkatëse.

1.

Nëse këshilli i bashkësisë lokale nuk vperon sipas propozimeve të organit nga paragrafi 1 i këtij neni, kryetari i komunës do ta anuloj aktin e përgjithshëm të bashkësisë lokale me aktvendim i cili hynë në fuqi me publikimin e tij në “Gazetën zyrtare të komunës së Bujanocit”

Këshilli komunal i propozon kryetarit të komunës ndalimin e financimit të aktiviteteve të bashkësisë lokale në të cilat mjetet financiare nuk shfrytëzohen në pajtim me planin financiar të bashkësisë lokale, vendimin mbi buxhetin ose ligjin.

- Neni 125.

Gjatë ushtrimit të punëve të veta Kuvendi komunalbie këto akte:

1. - Vendime,
2. – rregullore,
3. – aktvendime,
4. - konkluzione dhe
5. - rekomandime

Të gjitha aktet që i nxjerrë Kuvendi duhet patjetër të jenë në përputhje me ligjin dhe Statutin.

Aktet e kryetarit të komunës dhe aktet që i nxjerrë Këshilli komunal duhet patjetër të jenë në harmoni e ligjin, Statutin dhe vendimet të cilat i nxjerrë Kuvendi i komunës.

Publikimi dhe hyrja në fuqi e akteve të përgjithshme të cilat i bie Kuvendi i komunës.

- Neni 126.

Aktet që i nxjerrë Kuvendi komunal hyjnë në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në “Gazetën zyrtare të komunës së Bujanocit”, nëse kuvendi nuk vendosë ndryshe që akti të hyjë në fuqi në ditën e nxjerrjes.

Aktet të cilat i nxjerr Kuvendi komunal publikohen mbi parimin e barazisë edhe në gjuhët dhe shkrimet që janë në përdorim të barabartë dhe zyrtar në territorin e komunës.

VIII.

BASHKËPUNIMI DHE BASHKIMI I KOMUNËS

Bashkëpunimi dhe bashkimi i Komunës me komunat dhe qytetet e tjera të vendit

- Neni 127.

Komuna, organet dhe shërbimet e saja si dhe ndërmarrjet, entet dhe organizatat e tjera themelues i të cilave është komuna, bashkohen dhe realizojnë bashkëpunim me komunat dhe qytetet e tjera dhe me organet dhe shërbimet e tyre në fushat me interes të përbashkët dhe se për realizimin e tij mund t'i bashkojnë mjetet dhe të formojnë organe të përbashkëta, ndërmarrje, ente dhe organizata dhe ente të tjera, në pajtim me ligjin dhe statutin.

1.

Bashkëpunimi nga parag 1 i këtij neni nënkupton edhe dhënien e ushtrimit të punëve të caktuara nga kompetenca e Komunës njësisë tjetër të vetëadministrimit lokale ose ndërmarrjes, entit dhe organizatës tjetër themelues i të cilës është ajo.

Nëse Komuna lidhë marrëveshje bashkëpunimi me komunat e tjera ose me qytetin me qëllim të ushtrimit të përbashkët të punëve nga sfera e veprimtarive komunale, ato punë ushtrohen bashkërisht në pajtim me ligjin i cili i rregullon veprimtaritë komunale.

Bashkimi në asociacione të qyteteve dhe të komunave

- Neni 128.

Komuna themelon dhe mund të hyjë në asociacione të qytetave dhe të komunave me qëllim të avansimit të zhvillimit të vetëadministratës lokale, të mbrojtjes së saj dhe të realizimit të interesave të përbashkëta.

Komuna themelon ose i bashkohet asociacioneve të qyteteve dhe komunave të cilat përfaqësojnë interesat e anëtarësisë së vet para organeve shtetërore, veçmas në procedurën e nxjerrjes së ligjeve dhe akteve të tjera me rëndësi për realizimin e punëve në njësiti të vetëadministrimit lokal.

Bashkëpunimi me shoqatat dhe me organizatat e tjera

- Neni 129.

Organet e Komunës mund të bashkëpunojnë me organizatat joqeveritare, humanitare dhe me organizatat e tjera me interes për Komunën dhe qytetarët e saj.

Pjesëmarrja në integrimet europiane

- Neni 130.

Në kuadër të autorizimeve të veta komuna përmes organeve të veta e përcjellë procesin e integritimeve europiane të republikës së Serbisë dhe për këtë i zhvillon kapacitetet e nevojshme administrative, në pajtim me ligjin dhe politikën e përcaktuar të Republikës së Serbisë.

IX.

MBROJTJA E VETËADMINISTRIMIT LOKAL

- Mbrojtja e të drejtave të komunës

- Neni 131.

Mbrojtja e të drejtave të komunës sigurohet me mënyrën dhe procedurën e paraparë me ligj.

- Neni 135.

Inicimi i procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë

- Neni 132.

Kuvendi komunal inicon procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërinë të ligjit dhe të aktit tjetër të përgjithshëm të Republikës së Serbisë me të cilin shkilet e drejta në vetadministratë lokale.

**– E drejta e ankesës
Gjykatës kushtetuese**

- Neni 133.

Kryetari i Komunës ka të drejtë t'i ankohet Gjykatës kushtetuese nëse me aktin ose veprimin e caktuar të organit shtetëror ose organeve të Komunës pamundësohet ushtrimi i kompetencave të Komunës.

– Ombudsmani lokal

- Neni 134.

Në Komunë vendoset ombudsmani lokal.

Ombudsmani lokal i mbron të drejtat e qytetarëve i pavarur dhe i mëvetësishëm nga shkeljet e bëra nga ana e Administratës komunale dhe enteve e organizatave të cilat ushtrojnë autorizime publike, kurse themelues i të cilave është komuna. E kontrollon punën e Administratës komunale dhe i mbron të drejtat e qytetarëve në vetadministratën lokale, nëse bëhet fjalë për shkeljen e rregullave dhe të akteve të përgjithshme të Komunës.

Mëvetësia dhe pavarësia

Ombudsmani lokal punon dhe vepron në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës, ligjit, të marrëveshjeve të vërtetuara ndërkombëtare dhe të rregullave përgjithësisht të pranueshme të së drejtës ndërkombëtare si dhe statutit të Komunës.

Në veprimtarinë e tij ombudsmani lokal priret nga parimet e ligjshmërisë, paanshmërisë, pavarësisë dhe drejtësisë.

Me vendimin e Kuvendit të komuës detajizohet mënyra për t'iu drejtuar ombudsmanit lokal dhe rregullat e procedimit dhe punës së ombusmanit lokal.

**– Veprimi i
ombudsmanit lokal**

- Neni 136.

Mbi shfaqjen e puns jo të ligjshme dhe jo të padrejtë të Administratës komunale dhe shërbimeve publike që ushtrojnë autorizime publike, themelues i të cilave është Komuna, me të cilat shken të drejtat ose interesat e qytetarëve, ombudsmani lokal i paralajmëron këto organe dhe shërbime, iu drejton kritika, jep rekomandime për punë, e inicon procedurën për mënjanimin e shkeljes së të drejtave dhe për këtë e informon publikun;

Në domenin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe pakicave, ombudsmani lokal:

1)

e përcjellë jetësimin e të drejtave të njeriut dhe pakicave dhe jep rekomandime për

- përparimin e jetësimit të të drejtave të njeriut dhe pakicave; ushtron edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj, statut dhe me vendimin e Kuvendit të komunës.
- 2) grumbullon informacione mbi zbatimin e ligjit dhe të rregulalve të tjera nga sfera e mbrojtjes së të drejtave të njeriut i të drejtës në vetëadministrim lokal;
- 3) e përpilon raportin vjetor mbi jetësimin e të drejtave të njeriut dhe pakicave;
- 4) e njofton opinionin e gjerë mbi shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave;
- 5) pranon dhe i analizon parashtrësat që përkojnë me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe pakicave;
- 6) ndërmjetëson në zgjidhjen paqësore të kontesteve lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut;
- 7) inicon ndërmarrjen e procedurave përkatëse para organeve kompetente në rast të shkeljes së të drejtave të njeriut;
- 8) organizon dhe merrë pjesë në organizimin e takimeve profesionale, këshillimeve dhe fushatave informuese të opinionit mbi çështjet e rëndësishme për realizimin e të drejtave të njeriut dhe pakicave;
- 9) inicon dhe stimulon edukimin mbi të drejtat e njeriut dhe pakicave;
- 10)

Në ushtrimin e kompetencave të veta ombudsmani lokal bashkëpunon me ombudsmanët lokal në njësitë e tjera të vetëadministrimit lokal, si dhe me Mbrojtësin e qytetarëve në Republikë.

– Zgjedhja e ombudsmanit lokal

- Neni 137.

Ombudsmanin lokal e zgjedh dhe e shkarkon Kuvendi komunal me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve.

Propozimin për zgjedhjen dhe ombudsmanit lokal e paraqet grupi i këshilltarëve, së paku një e treta e këshilltarëve ose trupi punues i Kuvendit të komunës i cili i ushtron punët lidhur me çështjet kadrovike.

Ombudsmani lokal zgjedhet në periudhë për 5 vite dhe mund të zgjidhet sërish.

Për ombudsman lokal mund të zgjedhet personi i cili krahas kushteve të përgjithshme për arritjen e të drejtës zgjedhore (shtetësia, mosha madhore, zotësia e veprimit, vendbanimi në territorin e Komunës), e ka arsimin superior nga sfera shkencore e shkencave juridike në studimet themelore akademike në vëllim prej së paku 240 ECTS pikë, në studimet akademike master, në studimet specialistike akademike, në studimet profesionale specialistike, përkatësisht në studimet themelore në kohëzgjatje prej së paku katër vjetë ose në studimet specialistike në fakultet, i ka së paku pesë vjet në profesion, përvojë profesionale në punët e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe pakicave, të gëzojë integritet moral dhe të mos jetë i gjykuar penalisht e as që kundër tij të ndiqet procedurë penale.

Ombudsmani lokal nuk mund të jetë anëtar i partisë politike dhe nuk mund të ushtroj asnjë funksion publik e as kurrfar veprimtarie profesionale.

– Shkarkimi i ombudsmanit lokal

- Neni 138.

Ombudsmani lokal shkarkohet nga detyra para skadimit të mandatit nëse gjykohet për veprë penale me dënim me burg, nëse nuk i ushtron punët nga kompetenca e vet në mënyrë profesionale, të paanshme, të pavarur dhe në mënyrë të ndërgjegjshme me pozitën e ombudsmanit lokal.

Propozimi i arsyetuar për shkarkimin e ombudsmanit lokal mund të paraqitet nga grupi i këshilltarëve ose së paku nga një e treta e këshilltarëve.

Për shkarkimin e ombudsmanit lokal vendosë Kuvendi komunal me shumicë nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve.

Paraqitja e raportit në Kuvend

- Neni 139.

Ombudsmani ia paraqet raportin vjetor Kuvendit komunal.

Nëse vlerëson se raportimi është i nevojshëm për shkak të shqyrtimit të çështjeve të caktuara, ombudsmani lokal, Kuvendit të komunës mund t'i paraqesë edhe raporte të jashtëzakonshme.

Kuvendi komunal shqyrton raportet e ombudsmanit lokal në seancën e pare të radhës.

E drejta e pranisë në seancat e Kuvendit komunal dhe të trupave të tij punues

- Neni 140.

Ombudsmani lokal ka të drejtë të marrë pjesë në seancat e Kuvendit të komunës dhe të trupave të tij punues si dhe të marrë pjesë në diskutim kur shqyrtohet raporti për punën e Administratës komunale, përkatësisht të diskutoj për çështjet nga kompetenca e tij.

– Mjetet për punën e ombudsmanit lokal

- Neni 141.

Mjetet për punën e ombudsmanit lokal sigurohen në buxhetin e Komunës, ndërkaq mund të sigurohen edhe nga burime të tjera, në pajtim me ligjin.

X. – AKTET E KOMUNËS

– Aktet e Komunës

- Neni 142.

komunës, trupi punues i Kuvendit të komunës, Këshilli komunal dhe qytetarët përmes nismës qytetare.

Në ushtrimin e punëve nga kompetenca e vet Komuna bie vendime, rregullore, urdhëresa, udhëzime, aktvendime, përfundime, rekomandime dhe aktet e tjera të nevojshme.

Publikimi dhe hyrja në fuqi e akteve të përgjithshme

- Neni 145.

“ Aktet e përgjithshme të Komunës publikohen në “Gazetën zyrtare të Komunës së Bujanocit”.

Vendimet i bie vetëm Kuvendi komunal, përveç kur me ligj është paraparë që vendimin ta nxjerrë organi tjetër i Komunës.

1.

- Hierarkia e akteve të Komunës

- Neni 143.

Vendimet dhe aktet e përgjithshme të Kuvendit të komunës duhet patjetër të jenë të harmonizuar me ligjin dhe me këtë statut.

Aktet nga parag 1 i këtij neni hyjnë në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit, përveç nëse nxjerrësi në procedurën e nxjerrjes nuk përcakton se ekzistojnë arsye të rëndësishme të veçantë që i njëjti të hyjnë në fuqi më herët.

Aktet e tjera të Komunës publikohen në “Gazetën zyrtare të Komunës së Bujanocit” kur kjo është paraparë me ato akte.

XI.

INTERPRETIMI, NXJERRJA DHE NDRYSHIMI I STATUTIT

Aktet e Administratës komunale duhet patjetër të jenë në përputhje me ligjin, me këtë statut, me vendimet dhe me aktet e përgjithshme të Kuvendit të komunës.

- Interpretimi autentik i statutit

- Neni 146.

Propozimi i rregullave dhe i akteve të tjera të përgjithshme të Kuvendit të komunës

Interpretimin autentik të statutit e nxjerrë Kuvendi komunal me propozim të trupit të autorizuar punues të Kuvendit të komunës.

- Neni 144.

- Neni 147.

5%

Të drejtën e propozimit të rregullave dhe të akteve të përgjithshme nga kompetenca e Kuvendit të komunës e kanë: secili këshilltar i Kuvendit të

Propozimin për aprovimin apo ndryshimin e Statutit të komunës mund ta miratojnë së paku 5% e

zgjedhësve me të drejtë vote, një e treta e këshilltarëve, kryetari i Komunës dhe trupi kompetent i Kuvendit komunal.

vëmendshëm mbi propozimet dhe sugjerimet e dhëna në debat publik.

Propozimi paraqitet në formë të shkruar dhe i arsyetuar.

Kuvendi komunal aprovon Statutin dhe Vendimin mbi ndryshimin e Statutin me shumicë votash nga numri i përgjithshëm I këshilltarëve.

1.

Për propozimin nga parag. 1. të këtij neni Kuvendi vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve.

XII.

DISPOZITAT E PËRHERSHME DHE TË PËRKOHËSHME

Harmonizimi i rregullave të Komunës me këtë Statut

- Neni 148.

Me rastin e nismës së Kuvendit komunal për aprovimin ose ndryshimin e Statutit të Komunës me të njëjtin akt e cakton Komisionin për hartimin e draftit të vendimit mbi ndryshimin e Statutit të Komunës, i cakton detyrat e tij dhe afat in për hartimin e draftit.

Rregullat e Komunës do të harmonizohen me dispozitat e këtij statuti në afat prej nëntë muajve nga hyrja në fuqi e Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi vetëadministrimin lokal.

Draftin e Statutit, përkatësisht vendimit mbi ndryshimin e statutit e përcakton Këshilli komunal me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit komunal.

Rregullat e Komunës mbeten në fuqi deri te harmonizimi i tyre me këtë statut.

Nxjerrja e rregullave të Komunës në bazë të këtij statuti

- Neni 149.

Mbi draftin e statutit, përkatësisht vendimit mbi ndryshimin e Statutit bëhet debat publik në mënyrën dhe afatin të cilin e cakton Këshilli komunal.

Vendimet në bazë të këtij statuti Kuvendi komunaldo t'i nxjerrë në afat prej nëntë muajve nga hyrja në fuqi e Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi vetëadministrimin lokal.

Këshilli komunal, pas zbatimit të debatit publik, e përcakton propozim statutin, përkatësisht vendimin mbi ndryshimin e statutit, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit komunal. Me rastin e përcaktimit të propozim statutit, përkatësisht të vendimit mbi ndryshimin e statutit, Këshilli komunal do të jetë i

Formimi i Komisionit zgjedhor dhe Komisionit zgjedhor të shkallës së dytë

- Neni 150.

Kuvendi komunal do ta emëroj kryetarin, anëtarët dhe sekretarin e Komisionit zgjedhor dhe zëvendësit e tyre, në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij statuti.

1.

Bashkë me emërimet nga paragrafi 1 i këtij neni, Kuvendi komunal të njëjtën kohë do ta emëroj edhe kryetarin, anëtarët dhe sekretarin e Komisionit zgjedhor të shkallës së dytë.

Nxjerrja e dokumenteve të planifikimit në pajtim me këtë statut

- Neni 151.

01.01.2021.

Kuvendi komunal do ta nxjerrë Planin e zhvillimit të Komunës më së voni deri më 01.01.2021.

2021.

Kuvendi komunal do ta nxjerrë planin afatmesëm në pajtim me ligjin i cili rregullon sistemin e planit në RS, duke filluar nga plani afatmesëm për vitin 2021.

2.

Dokumentet në fuqi të politikave publike do të harmonizohen me ligjin nga paragrafi 2 i këtij neni, ndërsa me rastin e ndryshimeve dhe plotësimeve të para të këtyre dokumenteve.

Zbatimi i shtyer i dispozitave të caktuara të këtij statuti

- Neni 152.

57.

64.

65. 1.

Neni 57. që përkon me zëvendësin e kryetarit të KK, Neni 64. në pjesën e cila përkon me caktimin e ndihmësit të kryetarit të Komunës, Neni 65 paragrafi 1 në pjesën që përkon me numrin e anëtarëve të Këshillit komunal do të zbatohet pas zgjedhjeve të mbajtura për këshilltar të Kuvendit të komunës të mbajtur pas hyrjes në fuqi të këtij statuti.

108. 1. 2),

2020.

Neni 108 paragrafi 1 pika 2) që përkon me zbatimin e procedurës së obliguehme të debatit publik për planifikimin e investimeve në vendimin e buxhetit, do të zbatohet duke filluar nga përgatitja e Vendimit mbi buxhetin për vitin 2020.

-Shfuqizimi i

Statutit

- Neni 153.

(,, -
“, 24/08),

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet Statuti i Komunës së Bujanocit (“Gazeta zyrtare e Rrethit të Pçinjës nr. 24/08.”), me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet.

- Hyrja në fuqi

- Neni 154.

“.
Ky Statut hynë në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në “Gazetën zyrtare të komunës Bujanoc”.

KUVENDI KOMUNALBUJANOC

Broj - Numër:02-44/19

- KRYETAR
Adnan Salih, . - d. v.

:

PËRMBAJTJA E AKTEVE TË PUBLIKUARA:

– BUJANOC

STATUTIN I KOMUNËS BUJANOC 187

115

faks: 017/651-104, : **840-742351843-94**, : 017/654-365, 25.000,oo
:“ ” 2. 40

Botues: Komuna e Bujanocit, K. Petroviq 115 Bujanoc, redaktori përgjegjës: Selami Mustafa, sekretar i Kuvendit të Komunës së Bujanocit, redaksia: Shërbimi profesional për punët e Kuvendit të Komunës së Bujanocit, telefoni: 017/654-365, faks: 017/651-104, llogaria rrjedhëse: **840-742351843-94**, ekzekutimi i buxhetit të komunës së Bujanocit, çmimi i parapagimit vjetor 25.000,oo din, botohet në: “Plutos” Vranjë, Dragaçevska 2. Tirazhi 40 ekzemplar.